

---

## STATUT I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“INNOCLIMA ALBANIA” Sh.p.k

### Kreu I

### THEMELIMI, ZOTËRIMI, OBJEKTI I VEPRIMTARISË, KOHËZGJATJA, SELIA

#### Neni 1

#### Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit


Sot, më datë 14 / 09 /2021, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “INNOCLIMA ALBANIA” Sh.p.k.

#### Themeluesit e shoqërisë janë:

- **Znj. Christina KOUROUTHANASI**, e datelindjes 27.03.1968, lindur ne Athina, Greqi dhe banues ne Athine, Greqi shtetase Greke, madhore dhe me zotesi juridike per te vepruar, i identifikuar me pasaporte, leshuar nga Ministra e Brendshme me nr. AN 9262844, me vullnet të lire, të plote si themelues i kesaj shoqerie ne te cilen eshte ortak,
- **Z. Ioannis SKANTZIKAS**, i datelindjes 19.01.1956, lindur ne Mina, Greqi dhe banues ne Kostanca, Rumani, shtetas Greke, madhor dhe me zotesi juridike per te vepruar, i identifikuar me pasaporte, leshuar nga Ministra e Brendshme me nr. AT 2129054, me vullnet të lire, të plote si themelues i kesaj shoqerie ne te cilen eshte ortak,
- **Z. Antonios GIOXAS**, i datelindjes 22.08.1967, lindur ne Athina, Greqi dhe banues ne Bukuresht, Rumani shtetas Greke, madhor dhe me zotesi juridike per te vepruar, i identifikuar me i identifikuar me pasaporte, leshuar nga Ministra e Brendshme me nr. AT 0475628, me vullnet të lire, të plote si themelues i kesaj shoqerie ne te cilen eshte ortak,
- **Z. Mariglen HYSA**, i datelindjes 27.08.1975, lindur ne Peladhi, Shqiperi dhe banues ne Tirane, adresa: Rruga Muhamet Butka, Njesia Administrative Nr 5, Apartamenti 22, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotesi juridike per te vepruar, i identifikuar me pasaporte, leshuar nga Ministra e Brendshme me nr. Pasaporte BB 8466767 dhe H 50827004 T, me vullnet të lire, të plote si themelues i kesaj shoqerie ne te cilen eshte ortak,

#### Neni 2 Objekti

Shoqëria ka si objekt kryesor të saj:



- Importi, eksporti, tregtia me shumice dhe pakice e mallrave, materialeve dhe paisjeve, ne te gjithe format e saj per sa i perket blerjes dhe shitjes, instalimit, mirembajtjes, dhe riparimit te paisjeve mekanike, hidraulike, sistemeve te ngrohje-ftohjes etj etj.
- Pjesemarrja direkte dhe indirekte, sipermarrja dhe sherbimi ne fusha te ndryshme, kryerja e veprimtarive dhe/pse pjesemarrja ne cdo veprim dhe aktivitet ne perputheje me ligjet si dhe cdo aktivitet ekonomik qe do te gjykohet i nevojshem dhe i dobishem ne menyre qe te permbyshet qellimi i veprimtarise qe nuk bie ne kundershtim me legjislacionin shqiptar.
- Pjesemarrja direkte dhe indirekte ne te gjithe operacionet financiare, per pasurite e patundshme si dhe cdo aktivitet tregtar, financiar, dhenie marrje me qira, te vendose pengje dhe barre hipotekore, aktivitete keto qe kane aftesine te favorizojne zgjerimin dhe zhvillimin e saj.
- Shoqeria importon dhe eksporton cdo lloj produkti industrial nga te gjitha vendet e botes dhe kryen tregtimin e tyre per sa kohe qe e ben pjese te aktivitetit te saj ne zbatim te akteve ligjore dhe nenligjore ne fuqi duke zbatuar standartet me te larta te etikes.

### **Neni 3** **Forma Ligjore**

- 3.1 Shoqëria ka formën e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, në përputhje me ligjin për shoqëritë tregtare në Republikën e Shqipërisë.
- 3.2 Shoqëria ka të drejtë të hapë degë apo filiale, zyra përfaqësimi, në të gjithë vendin gjatë aktivitetit të saj.

### **Neni 4** **Baza ligjore**


- 4.1 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj në përputhje me këtë Statut, Ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (“Ligi i Shoqërive Tregtare”), dhe çdo dispozitë tjeter të zbatueshme të legjislacionit shqiptar.

### **Neni 5** **Kohëzgjatja e Veprimtarisë**

- 5.1 Shoqëria krijohet për të vepruar për nje afat te pacaktuar, duke filluar nga data e rregjistrimit te saj ne QKB, Tirane. Ne përputhje me kete statut, shoqëria mundet te mbylli veprimtarinë e saj kur e sheh e arsyeshme apo ne raste te parashikuara ne ligj.

### **Neni 6** **Selia/Adresa e Regjistruar**

- 6.1 Shoqeria “INNOCLIMA ALBANIA” Sh.p.k, do ta kete seline e saj ne qytetin e Tiranes, rruga ‘Muhamet Gjollesha”, Pallati “Tirana Ring Center”, Hyrja 1, Ap 21, Tirane.



2

- 
- 6.2 Administratori, në përputhje me kompetencat që i jep statuti mund të hapë adresa sekondare të shoqërisë që kanë lidhje vetëm me aktivitetin e përcaktuar në Nenin 2, "Objekti i veprimitarise".

## KREU II

### Neni 7 Kapitali themeltar

- 7.1 Kapitali themeltar fillestar i Shoqërisë është 1,000.000 (*nje milion*) Lekë.
- 7.2 Kapitali i shoqërisë është i ndarë në 4 pjesë (kuota), dhe 1 pjesë (kuotë) me vlerë nominale 80 000 (*tetedhjete mijë*) lekë, 1 pjese (kuotë) me vlere nominale 220 000 (Dyqind e njezet e dy mijë) leke, 1 pjesë (kuote) me vlere nominale 320 000 (Treqind e njezet mijë) leke dhe 1 pjesë (kuotë) me vlerë nominale 380 000 (*treqind e tetedhjete mijë*) lekë .
- 7.3 Kuotat do të zoterohen nga ortakët sipas ndarjes së mëposhtme:
- Znj. Christina KOUROUTHANASI, zotërues i 8 % të kapitalit të Shoqërisë;
  - Z. Joannis SKANTZIKAS, zotërues i 22 % të kapitalit të Shoqërisë;
  - Z. Antonios GIOXAS, zotërues i 32 % të kapitalit të Shoqërisë;
  - Z. Mariglen HYSA, zotërues i 38 % të kapitalit të Shoqërisë;

### Neni 8 Zmadhimi i Kapitalit

- 8.1 Kapitali themeltar mund të zmadhohet ose të zvogëlohet nga Asambleja e Përgjithshme me 100% te votave.
- 8.2 Zmadhimi i kapitalit të Shoqërisë mund të kryhet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.
- Zmadhimi i kapitalit mund të vendoset kur e kërkojnë interesat e shoqërisë duke vendosur kuotat suplementare të Ortakëve. Do t'u ofrohen për nënshkrim kuota të reja vetëm ortakëve ekzistues të Shoqërisë. Nëse kuotat e reja do tu ofrohen për nënshkrim një pale të tretë atëherë duhet miratimi me Shumicë të Cilësuar i Asamblesë së Ortakëve.
- 8.3 Ortakët mund të financojnë shoqërinë nëpërmjet financimeve me pagesa, me interes ose pa interes, qoftë si kontribute në kapital ose jo, edhe objekt rimbursimi, në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi.



Handwritten signatures of the shareholders, including Znj. Christina KOUROUTHANASI, Z. Joannis SKANTZIKAS, Z. Antonios GIOXAS, and Z. Mariglen HYSA, are present here. A small number '3' is written near the bottom right signature.

---

Në rastet kur shoqëria do të gjendet përballë rasteve të nevojshme për zmadhimin e kapitalit nëpërmjet financimit të ortakëve të shoqërisë, atëherë ortakët angazhohen të kryejnë financimet përkatëse.


- 8.4 Në rastin kur një ortak kundërshton parashikimin e mësipërm, atëherë asambleja e ortakëve do të proçedojë me zmadhimin e kapitalit sipas parashikimeve të Ligjit, ndërkohë që ortakut që nuk merr pjesë në financim i zbritet përqindja që ai zoteron ne kapitalin e shoqërisë.
- 8.5 Mënyra e rritjes së kapitalit në lidhje me metodat dhe afatet e pagimit të kontributeve nga ortakët do të vendoset rast pas rasti me vendim të Asamblesë së Ortakëve. Vendimet e Asamblesë së Ortakëve mund të përfshijnë ndër të tjera dënimet dhe pasojat për një ortak në rast të mos-pagesës së kontributit të rënë dakord në afatin dhe shumën e caktuar duke përshirë, po pa u kufizuar, (i) zvogëlimin proporcional të pjesës të ortakut në Shoqërisë, (ii) shitjen e detyruar të pjesës së ortakut në Shoqëri, (iii) përcaktimit, në bazë të një vlerësimi profesional ose formule, të vlerës së cilësdo pjesë të ortakut që është paguar, dhe shitjen e detyruar të asaj pjesë në vlerën e përcaktuar.
- 8.6 Pavarësisht sa më sipër, zmadhimi i kapitalit nuk do të zvogëloje pjesët e interesit të ortakëve në kapitalin e shoqërisë, përvèç se kur të gjithë ortakët janë dakord.

### **Neni 9** **Zvogëlimi i Kapitalit**

- 9.1 Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.
- 9.2 Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.
- 9.3 Zvogëlimi i kapitalit nuk duhet të dëmtojë kreditorët e as të krijojë pasiguri tek ata që kanë dhënë kredi para publikimit të zvogëlimit të kapitalit. Në të kundërtën Gjykata e konsideron të pavlefshëm këtë vendim mbi kërkesën e kreditorëve.

### **Neni 10** **Transferimi i kapitalit. Kufizimet mbi transferimin**

- 10.1 Kuotat e kapitalit të shoqërise me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
- kontributit në kapitalin e shoqërisë;
  - shitblerjes;
  - trashëgimisë;
  - dhurimit;
  - çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.



Handwritten signatures and initials in blue ink, including 'A. B.', 'H. J.', and 'O. M.' with the number '4' written near the bottom right.

---

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

- 10.2 Nëse një ortak vdes bashkëzotëresit e mbetur gjallë dhe trashëgimtarët e tij janë të vetmit persona të cilët Shoqëria i njeh si titullarë të kuotës të tij; asnje dispozitë e këtushme nuk e çliron pasurinë e ortakut të vdekur nga përgjegjësia në lidhje me kuotën që ka pasur në zotërim i vetëm ose bashkërisht.
- 10.3 Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku mundet që pas paraqitjes së provave të kërkua nga Administratorët, të vendosë ose të bëhet zotëresi i kuotës ose të kërkojë që si zotëres i kuotës të regjistrohet një person tjetër i caktuar prej tij. Nëse vendos të bëhet zotëres vetë, ai e njofton shoqërinë në lidhje me këtë. Nëse vendos që të kërkojë që si zotëres i kuotës të regjistrohet një person tjetër, ai shfrytëzon një instrument të kalimit të kuotës te ky person tjetër.
- 10.4 Personi që e fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku gjëzon të drejtat, titullar i të cilave do të kishte qenë si zotëres i kuotës, me përjashtim të faktit që, përparrë se të regjistrohet pranë QKR-së, ai nuk gjëzon të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në Asamblenë e Ortakëve.
- 10.5 Transferimi i kuotave tek palët e treta ose ndërmjet ortakëve mund të bëhet vetëm me anë të një kontrate me shkrim dhe pasi të jenë plotësuar kushtet në vijim:
- 10.6 Në çdo rast tjetër të transferimit të pjesëve të kapitalit jashtë strukturës të ortakërisë, ortakët gjëzojnë të drejtën e parablerjes. Ortaku i cili dëshiron të transferojë kuotën e tij do të njoftojë ortakët e tjerë nëpërmjet një njoftimi me shkrim i cili duhet të përcaktojë dhe kushtet e transferimit.  
Ortakët e shoqërisë njoftojnë qëllimin e tyre për të ushtruar të drejtën e parablerjes brenda 30 ditëve nga njoftimi. Në rast se asnje prej ortakëve nuk ushtron të drejtën e parablerjes brenda afatit të përcaktuar më sipër, atëherë ortaku që kërkon të largohet ka të drejtë të transferojë tek të tretët kuotën e tij.  
Personi që kalon kuotën dhe ai që fiton atë përgjigjet në mënyre solidare ndaj Shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës nga çasti i kalimit të kuotave deri në çastin e regjistrimit të kalimit.

### KREU III

#### ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

##### Neni 11

##### Organë vendimmarrës

- 11.1 Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.




- 
- 11.2 Çdo kuotë garanton të drejtën e një vote në asamblenë e përgjithshme të ortakëve ("Asambleja e Ortakëve"), të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur në organet drejtuese, të drejtën për të marrë pjesë në shpërndarjen e fitimit të Shoqërisë si dhe të drejtat e siguruara nga ky Statut, marrëveshjet midis ortakëve dhe parashikimet e Ligjit Tregtar.
- 11.3 Vetëm Asambleja e Ortakëve do të ketë të drejtë të vendosë për çështjet e mëposhtme:
- Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - modifikimin dhe ndryshimin e këtij Statuti;
  - të vendosë për emërimin dhe shkarkimin e administratorëve të Shoqërisë;
  - miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë;
  - të zmadhojë dhe/ose zvogëlojë kapitalin e regjistruar;
  - vendosë për shkrirjen, prishjen, likuidim dhe çdo lloj transformimi tjeter të Shoqërisë;
  - emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - të themelojë dhe/ose mbyll degë dhe përfaqësi jashtë dhe brenda Shqipërisë;
  - të miratojë raportet vjetore dhe bilancet dhe të miratojë shpërndarjen e fitimit;
  - përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në proçedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - të vendosë mbi përvetësimin, shitjen dhe vendosjen e barrës mbi pasuritë;
  - riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë ;
  - të vendosë pagën e Administratorit;
  - të vendosë për caktimin e ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - të vendosë mbi organizimin strukturor dhe administrativ të Shoqërisë;
  - të vendosë mbi buxhetin vjetor;
  - miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
  - të vendosë për çdo çështje tjeter, që i takon për zgjidhje asamblesë së ortakëve, me ligj dhe/ose sipas këtij statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjeter apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëtin rend dite.


**Neni 12**  
**Vendimet e Asamblesë së Ortakëve**



- 
- 12.1 Vendimet, të listuara më sipër, në lidhje me ndryshimin e këtij Statuti, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit, shpërndarjen e fitimit, marrjen e huave apo dhënien e garancive nga Shoqëria, organizimin dhe shpërndarjen e Shoqërisë kërkojnë një shumicë të cilësuar prej 100 % të ortakëve prezentë ose të përfaqësuar në asamble, në bazë të kërkesave të kuorumit të parashikuara në Nenin 14 më poshtë (“**Shumicë e Kualifikuar**”). Të gjitha vendimet e tjera të Asamblesë së Ortakëve mund të miratohen me shumicë të zakonshme të ortakëve prezent apo të përfaqësuar në asamble, në bazë të kërkesave të kuorumit në Nenin 14 më poshtë (“**Shumicë e Zakonshme**”). Vendimet e Asamblesë së Ortakëve për caktimin e administratorit miratohen me Shumicë të Zakonshme.

### **Neni 13** **Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve**

- 13.1 Asambleja e Ortakëve do të thirret nga Administratori i Shoqërisë nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim nëpërmjet postës elektronike të paktën një herë në vit në selinë e Shoqërisë ose në çdo vend tjetër të përcaktuar në njoftim brenda gjashtë muajve të parë të çdo viti kalendarik për të miratuar pasqyrat financiare të Shoqërisë të vitit të mëparshëm financiar.
- 13.2 Asambleja e përgjithshme thirret nga Administratori edhe nëse,
- a. sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
  - b. Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të Shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
  - c. Shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të Shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- 13.3 Më tej, anëtarët që përfaqësojnë të paktën 5% të votave të përgjithshme të Shoqërisë mund t'i kërkojnë administratorit me shkrim apo me postë elektronike thirrjen e asamblesë së ortakëve. Kërkesa duhet të mbajë arsyet dhe objektivat dhe çështjet për të cilat asambleja e ortakëve duhet të vendosë.
- 13.4 Asambleja e Ortakëve do të thirret me njoftim me shkrim të lëshuar nga administratori, i cili duhet t'u dërgohet përfaqësuesve të ortakëve me letër rekomande ose faks ose postë elektronike (e-mail) jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpëra ditës së caktuar për asamblën. Njoftimi për ortakët duhet të përcaktojë datën, orën dhe vendin e mbledhjes së asamblesë si dhe çështjet për t'u diskutuar (rendi i ditës) dhe, në rast të një asambleje të zakonshme të ortakëve, duhet të përfshijë pasqyrat e plota financiare dhe raportin e administrimit.



Handwritten signatures of the members of the Assembly of Stakeholders, including "A. B.", "G. G.", and "C. C.".

- 
- 13.5 Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjeter në përputhje me nenin 85 të Ligji të Shoqërisë Tregtare.

#### Neni 14

#### Vendimet e miratuara në Asamblenë e Ortakëve, Kuorumi

- 14.1 Në rastin e vendimeve të miratuara me Shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse janë prezent ortakët me të drejtë vote që kanë më shumë se 50% të kuotave të nënshkruara.
- 14.2 Në rastin kur Asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje të cilat kërkojnë Shumicë të kualifikuar, Asambleja e Ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse janë prezent ortakët që zoterojnë më shumë se 75% e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike.,
- 14.3 Nëse Asambleja e Ortakëve është e mbledhur në mënyrë korrekte, por numri i kërkuar i ortakëve për të plotësuar kuorumin nuk është prezent apo nuk është i përfaqësuar, asambleja e ortakëve do të mblidhet sërisht në përputhje me parashikimet e Nenit 14 por jo më vonë se 30 ditë. Rendi i ditës i asamblesë së dytë nuk do të ndryshojë.
- 14.4 Kur Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve nuk është thirrur sipas formalitetave të ligjit ose këtij statuti, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë të pranishëm dhe shprehen dakord për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.
- 14.5 Ortakët kanë të drejtën, që u njihet nga ligji apo statuti, për të marrë unanimisht çdo vendim, me kusht që ai të formalizohet me shkrim.
- 14.6 Asambleja e përgjithshme vendos me 100% e votave të zotëruarve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

#### Neni 15

#### Procesverbalet e Asamblesë së Ortakëve

- 15.1 Të gjitha vendimet e Asamblesë së Ortakëve duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratori përgjigjet për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve. Prosesverbal duhet të përbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalist, rezultatet e votimit si dhe ti bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.
- 15.2 Prosesverbal i Asamblesë së Ortakëve nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalist. Kryetari i Asamblesë së Ortakëve do të zgjidhet nga ortakët e pranishëm në Asamblenë e Ortakëve, me Shumice të Thjeshtë para fillimit të asamblesë, ndërsa mbajtësi i procesverbalist do të caktohet nga kryetari i Asamblesë së Ortakëve. Asambleja e Ortakëve mund të vendosë që procesverbalit të mbahet nga një noter publik në të cilin rast nuk është e nevojshme caktimi i mbajtësit të procesverbalist dhe nënshkrimi i procesverbalist nga

A photograph showing several handwritten signatures in blue ink, likely belonging to the members of the Assembly of the Community of the Three, positioned at the bottom right of the page.

---

kryetari i mbledhjes. Esktraktet e procesverbalit të Asamblesë së Ortakëve për qëllim depozitimi në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit janë të vlefshme nëse nënshkruhen nga të gjithë ortakët pjesëmarrës në Asamblenë e Ortakëve ose nga Administratori i Shoqërisë.

### **Neni 16** **Përjashtimi nga e drejta e votës**

- 16.1 Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja e Ortakëve merr vendime për:
  - a. vlerësimin e veprimtarisë së tij;
  - b. shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
  - c. ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
  - d. dhënen ose jo të përfitimeve të reja;dhe çdo rast tjetër të parashikuar në Ligjin për Shoqëritë Tregtare.
- 16.2 Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

### **Neni 17** **Administrimi i Shoqërisë dhe kompetencat e administratorit**

- 17.1 Shoqëria do të administrohet nga dy administratore, te emëruar në përputhje me këtë statut.
- 17.2 Administratoret e Shoqërisë mund të shkarkohet nga pozicioni që ka në Shoqëri në çdo kohë nga Asambleja e Ortakëve me Shumice të Zakonshme. Në asnjë rast ortakëve nuk i duhet të justifikojnë apo provojnë se cilat janë shkaqet për të cilat ata shkarkojnë administratorin. Në cdo rast janë ortakët ata të cilët vlerësojnë se ka shkaqe të arsyeshme për shkarkimin e administratorit
- 17.3 Administratori ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë në mënyrë të plotë për administrimin e zakonshëm të saj si edhe të drejtën për të miratuar të gjitha vendimet që i gjykon të përshtatshme për arritur dhe përmbrushur qëllimin e shoqërisë, me përjashtim të vendimeve që me ligj i takojnë Asamblesë së Ortakëve.

Administratori mund të autorizojë palë të treta për ta përfaqësuar atë në transaksione të veçanta me anë të një prokure të hartuar para noterit.

- 17.4 Të vendosë marrjen e huave apo dhënen e garancive nga Shoqëria;
- 17.4 Personat i mëposhtëm do të caktohet si Administrator i Shoqërisë për një afat **5 vjeçar me te drejte rinovim:**



**Z. Mariglen HYSA**, shtetas shqiptar, lindur më 27.08.1975 në Peladhi, Diber dhe banues në Tiranë, Shqipëri, madhor dhe me zotësi te plote juridike per te vepruar, mbajtës i letërnjoftimit nr. BB 8466767 dhe nr.personal H 50827004T, lëshuar nga Ministria e Brendshme datë 27.04.2017 me speciment nënshkrimi *Mariglen Lysa* *Hyse*.

**Z. Antonios GIOXAS**, shtetas greke, lindur me 22.08.1967, në Athina, Greqi dhe banues ne Bukuresht, Rumani, madhor dhe me zotesi juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes me nr. AT 0475628, leshuar nga Ministria e Brendshme me date 05.08.2020 me speciment nenshkrimi *Antonios Gioxas* *A*

Të drejtat dhe detyrimet e Administratorit janë ato të përcaktuara në Ligjin e Shoqërive Tregtare, këtë Statut, vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve dhe rregullat e brendshme të administrimit të Shoqërisë.

17.4 Administratoret kane të drejtat dhe detyrimet te veprojnë bashkarisht dhe vec e vec si me mëposhtme:


- a. përfaqësimin e Shoqërisë kundrejt palëve të treta dhe shtetit;
- b. hapjen e llogarive bankare të Shoqërisë me bankat;
- c. përfundimin e marrëveshjeve me palët e treta, lëshimin dhe marrjen e urdhër pagesave, pa miratim me shkrim nga ortaket;
- d. nënshkrimin e të gjithë dokumenteve, lëshimin e faturave, transferimet në monedhë të huaj, fletë ngarkesat etj, pagimin e detyrimeve të Shoqërisë dhe pranimin e letrave me vlerë nga palët e treta;
- e. vlera e transaksioneve bankare që lejohet të kryhet nga administratori nuk do te kenë kufizim;
- f. mbledhjen e detyrimeve që i takojnë shoqërisë;
- g. punësimin dhe shkarkimin e stafit të Shoqërisë, përcaktimin e pagave, shpërblimeve dhe pagesave të stafit, pa miratimit me shkrim nga ortaket;
- h. të vendosë marrjen e huave apo dhëni e garancive nga Shoqëria;
- i. marrjen e masave paraprake për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë, ngritjen e padive dhe marrjen përsipër të mbrojtjes së Shoqërisë në rast të padive kundër saj; administratori mund të udhëzojë avokatët të mbrojnë Shoqërinë dhe mund të përcaktojë shumën e shpërbimit të tyre me miratimin paraprak të Asamblesë së Ortakëve;
- j. administratoret ka të drejtë të ngrejë padi dhe t'i térheqë ato, të nënshkruajë marrëveshje gjyqësore, të mbyllë marrëveshje arbitrazhi, të caktojë arbitra, të térheqë paditë e ngritura nga Shoqëria dhe të ndërpresë procedimet por në cdo rast përpara kryerjes së ndonjë prej veprimeve të mësipërmë, administratori duhet të marrë miratimin e Asamblesë së Ortakëve.
- k. ndërmarrjen e të gjithë veprimeve të tjera që i takojnë aktivitetit të përditshëm të Shoqërisë nga pikëpamja e ligjit dhe këtij Statuti;
- l. mbajtjen e llogarive në përputhje me ligjin dhe parimet e kontabilitetit;

- 
- m. përgatitjen e pasqyrave vjetore financiare të Shoqërisë dhe kontrollin e tyre nga auditorë të jashtëm nëse kjo kërcohët nga ligji ose nga një vendim i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve;
  - n. thirrjen e mbledhjeve të Ortakëve; përcaktimin e rendit të ditës; monitorimin e përbushjes së dispozitive që kanë lidhje me thirrjen dhe drejtimin e mbledhjes së përgjithshme të Ortakëve për shpalljen e vendimeve përkatëse;
  - o. të vendosë në dispozicion të Ortakëve të Shoqërisë sa herë që të kërcohët prej tyre informacionet, raportet dhe dokumentet në lidhje me shpenzimet e Shoqërisë, gjendjen e llogarive bankare, inventarin, deklarata për të hyrat, deklarata të tjera financiare, fletëparaqitjet timore të Shoqërisë dhe auditet, nëpërmjet formës së kërkuar dhe njoftuar nga seци Ortak, si p.sh. nëpërmjet faxit, postës elektronike apo postës së zakonshme.
  - p. administratoret janë të detyruar të therrasin asamblënë e përgjithshme të Ortakëve në rastet kur:
    - sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
    - shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyre tjetër aktive të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.
    - shoqëria brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.
  - q. kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të Shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
  - r. përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
  - s. çdo detyrë tjetër të parashikuar në ligj.

#### **KREU IV** **VITI FINANCIAR – EKSPERTËT- BILANCI**

##### **Neni 18** **Viti Financiar dhe Dividendi**

- 18.1 Viti Financiar i aktivitetit të Shoqërisë përkon me vitin kalendarik, fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të çdo viti. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllt më datë 31 Dhjetor.



A handwritten signature in blue ink, appearing to be in the name of the auditor, is placed here. The signature is somewhat stylized and includes the number '11' at the end.

- 
- 18.2 Pas përcaktimit të fitimit të Shoqërisë në përputhje me pasqyrat financiare dhe pas përbushjes së kërkesave së nenit 77 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, fitimi i Shoqërisë, deri sa të shlyhet shuma e investimit fillestar, ndahet midis ortakëve sipas përqindjes së tyre në shoqëri.

**Neni 19**  
**Eksperti(ët) Kontabël të Autorizuar**

- 19.1 Eksperti(ët) Kontabël i Autorizuar do të emërohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, nëse është e nevojshme.
- 19.2 Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.
- 19.3 Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit finanziar vjetor si dhe për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.


**Neni 20**  
**Bilanci, Mbajtja e Llogarisë**

- 20.1 Bilanci i Shoqërisë kontrollohet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve dhe duhet të përgatitet për t'ju paraqitur organeve tatumore përpërfundimit të muajit mars të vitit pasues.
- 20.2 Librat e llogarisë duhet të mbahen në gjuhën shqipe dhe në monedhën vendase (Lek). Shoqëria mund të mbajë llogari të veçanta në monedhë të huaj, shuma e të cilave duhet të konvertohet, çdo muaj, në monedhën vendase.
- 20.3 Shoqëria mund të marrë financime nga institucione financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë saj. Për këtë arsy Shoqëria mund të vendosë barrë siguruese mbi kuotat si garanci, ose mund të hipotekojë pasurinë e paluajtshme të saj, me vendim të Asamblesë së Ortakëve të marrë me Shumicë të Cilësuar.

**KREU V**  
**PRISHJA – RIORGANIZIMI I SHOQËRISË**

**Neni 21**  
**Prishja dhe likuidimi**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë nga Asambleja e Ortakëve me Shumicë të Cilësuar:



- 
- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
  - b) me vendim të Asamblesë së ortakëve;
  - c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
  - d) nëse nuk ka kryer veprimitari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimitarisë ;
  - e) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej shoqërisë emrin e likudatorit dhe emërtesën shtesë “ Shoqëri në likuidim e sipër”.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesi i emëruar nga Ortakët.

Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesit, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues. Likuiduesi(t) do të përgatisin raportin e likuidimit, i cili përmban një përbledhje të gjendjes ekonomike të Shoqërisë, hapat e likuidimit dhe kohën e nevojshme përfundimin e tij. Në fund të këtij procesi, Asambleja e Ortakëve do të kontrollojë bilancin përfundimtar dhe do të japë miratimin përfundimin e procedurës së likuidimit.

### **Neni 22 Largimi dhe përjashtimi i Ortakut**


Largimi dhe përjashtimi i ortakut do të kryhet në përputhje më nenet 101, 102 dhe 103 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

### **Neni 23 Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas vendimit të mbledhjes së përgjithshme të asamblesë së ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”

### **Neni 24 Marrëdhëni e punës**

Marrëdhëni e punës rregullohen nëpërmjet kontratës së punës dhe legjislacionit të punës në fuqi. Shoqëria merr përsipër të respektoje rregullat në fuqi të punësimit dhe të punësuarit janë të detyruar që të respektojnë Statutin e kësaj Shoqërie dhe rregullat e brendshme të saj. Të



A handwritten signature in blue ink, appearing to be a stylized version of the name "Q. Hoxha". To the right of the signature, the number "13" is written vertically.

---

punësuarit duhet të përgjigjen për dëmet që i shkaktojnë kësaj Shoqërie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

**Neni 25**  
**Ndryshimet në Statut**

Dispozitat e këtij Statuti mund të ndryshohen nga Asambleja e Ortakëve, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

**Neni 26**  
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**


Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**Neni 27**  
**Dispozita Përfundimtare**

Ky Statut u redaktua ne 3 ekzemplare me përbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhënshqipe, u miratua në parim nen per nen nga Ortakët e shoqerisë tregtare “**INNOCLIMA ALBANIA**” sh.p.k., nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën orgjinale.

**ORTAKËT**  
**E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“INNOCLIMA ALBANIA” sh.p.k.**


**Zj. Christina KOUROUTHANASI**



**Z. Antonios GIOXAS**



**Z. Joannis SKANTZIKAS**



**Z. Mariglen HYSA**

